


# Bibël për fëmijët paraqet

## Jezusi Shëron të Verbërin



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Tregimi 50 nga 60

[www.M1914.org](http://www.M1914.org)

*Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada*

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian

Bartimeu ishte një njeri i verbër, që ulej anës rrugës që të çonte në Jeriko, për të lypur. Disa njerëz zemërmirë i jepnin kush ndonjë monedhë të vogël, kush ndopak ushqim ndërsa kalonin andej. Bartimeu nuk mund të punonte sepse ai nuk shihte dot. Ai vetëm mund të lypte.




1

Një ditë, rruga e gjerë ishte shumë e zënë. Bartimeu dëgjoi zhurmën e shumë këmbëve. Diçka e pazakontë po ndodhte.



2

Shpejt njeriu i verbër mësoi çfarë ishte. Jezusi i Nazaretit ishte në qytet. Turmat u mblodhën për të parë e për ta dëgjuar Atë.



3

"Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua"! Përse po thëriste Bartimeu? Përse mendonte ai se Jezusi mund ta ndihmonte? Mbase ai kishte dëgjuar për të tjerët që Jezusi kishte shëruar.



4

Disa ishin të shurdhër, disa memecë, disa të çalë - dhe disa të verbër, siç ishte ai. "Bir i Davidit ki mëshirë për mua", thërriste e thërriste, Bartimeu. Zëri i tij tingëllonte me shpresë.




5

Bartimeu ishte i sigurt për një gjë. Nëse ai nuk do të gjente ndihmë tani, ai mund të mos kishte një rast tjetër. Jezusi mbase nuk do të kalonte sërish andej.



6

Bartimeu duhej të shkonte tek Jezusi, por njerëzit nuk lëviznin. "Shshshh", ia bënë ata, duke i thënë Bartimeut të rrinte urtë.




7

Por Bartimeu nuk e qepi gojën. Ai vazhdoi të thërrasë. Papritmas, Jezusi ndaloi! Dëgjo! Urdhëroi që të sjellin njeriun e verbër tek Ai! "Merr zemër", njerëzit i thanë Bartimeut. "Çohu, Ai po të thërret".



8

Duke hedhur tutje mantelin e tij,  
Bartimeu u çua dhe rendi tek Jezusi.



9

Jezusi e pyeti, "Çfarë do që të  
bëj Unë, për ty"? Si mund të ishte  
përgjigjur ti? A do kishe kërkuar  
ti shumë para ose rroba të reja  
të bukura? Ishte kjo, ajo  
çfarë kërkoi Bartimeu?



10

Jo, Bartimeu i verbër nuk i  
kërkoi Jezusit ar ose rroba të  
bukura. Ju e dini  
çfarë donte  
ai.



11

"Zot, që unë të mund të rimarr shikimin". Bartimeu  
donte të shikonte. Të shihte pemët, dhe zogjtë  
dhe...gjithë krijimin e mrekullueshëm të Perëndisë.




12

Ai donte të shihte që të mund të  
kujdesej për veten e tij dhe  
të mos ishte më  
një lypsar.



13

Atëherë Jezusi i tha Bartimeut: "Merre  
shikimin tënd. Besimi yt të shpëtoi".



14

Menjëherë ai rimori shikimin e tij dhe ndoqi Jezusin.



15

E gjithë ajo që ai mund të thoshte ishte "Perëndia është i mrekullueshëm; Ai, më shëroi mua"!

Ishin çaste të mrekullueshme për Bartimeun.



16

Të gjithë njerëzit, kur e panë, i dhanë lavdinë Perëndisë.



17

Edhe njëherë, ata kishin parë fuqinë e mrekullueshme të Jezusit, Birit të Perëndisë, që i kishte dhënë shikimin një lypsari të verbër e varfanjak.



18

Jezusi Shëron të Verbërin

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Markut 10, Llukës 18, Gjonit 9

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mëkatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shume sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

**Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!**

